

LINK: <http://www.interreg-danube.eu/approved-projects/eguts>

Buxheti total eGUTS – 1,819,075.00 €

Buxheti i Komunës së Ulqinit – 51,000.00 €

Kontributi IPA – 43,350.00

ENI – 0

EGUTS - SISTEMET E TRANSPORTIT URBAN ELEKTRIK, ELEKTRONIK DHE TË GJELBËR

Projekti eGUTS synon shfrytëzimin e potencialeve të e-mobilitetit, (mjetet e transportit me shtytje elektrike) në 8 qytete të rajonit të Danubit, dhe më gjërë, e gjitha kjo në kuadër të programit transnacional Interreg të Danubit. Me qëllim të arritjes së këtij synim, projekti eGUTS bën përmbledhjen e rrjetit prej 22 partnerëve që do zhvillojnë standartet inovative eGUTS për qytetet, përkrah e-mobilitetin, kombinon studimet e fizibilitetit që do zhvillohen dhe implementojnë planin e aksionit lokal, përpilimin dhe testimin e aplikacionit eGUTS (aplikacion për smartphone), implementimin e projekteve pilot të ndryshme në fushën e rregulloreve dhe kërkesave të nevojshme në trafik dhe parkim, stacioneve për mbushje, shfrytëzimin dhe huazimin e sipërfaqeve publike dhe të ngjashme.

Për më tepër, ky konzorcium i qyteteve do rrisë në mënyrë aktive intentzitetin e bashkëpunimit, këmbimin e përvojave në mes të akterëve kompetentë, në nivel transnacional, rajonal dhe në nivelin nacional me fokus të posaçëm në nevojat e përdoruesëve (komuniteti lokal dhe turistë). Si pasojë, përmirësimi dhe koordinimi i implementimit të strategjisë eMOB pritet të japë rezultat jo vetëm ndër rajonet, por edhe të shfrytëzojë rezultatet në rajonin Danubian, dhe më gjerësisht në gjithë Evropën.